

Партнерство за
Отворена
Власт на
**Северна
Македонија**



RAPORTIM I PAVARUR: Republika
e Maqedonisë së Veriut

FUSHA PRIORITARE:
Transparenca, llogaridhënia,
proaktiviteti dhe inkluziviteti

RAPORT PËR IMPLEMENTIMIN:
tetor 2021 - tetor 2022

Liljana Jonoski, Koalicioni Rural





Në prag të përpilimit të Planit të pestë nacional aksional për Partneritetin për qeverisje të hapur 2021 - 2023 (PNA për PQH 2021 - 2023), u formua Rrjeti i organizatave qytetare për PQH me qëllim që organizatat qytetare të veprojnë dhe ndikojnë në mënyrë më të organizuar në krijimin e tij, si dhe që të nxitin dhe monitorojnë zbatimin e planit ekzistues dhe planeve të tjera aksionale.

Me qëllim që të sigurohet përfshirje e organizatave qytetare në mbështetjen dhe ndjekjen e zbatimit të PNA-së për PQH 2021 - 2023, Rrjeti për PQH mori pjesë dhe kontribuoi në vendosjen e strukturës për koordinim dhe monitorim të zhvillimit dhe zbatimit të PNA-së për PQH 2021 - 2023 duke siguruar monitorim të pavarur të zbatimit.



Rezymeja përmbledhëse:	
Republika e Maqedonisë së Veriut -	
Transparenca, llogaridhënia, proaktiviteti dhe inkluziviteti	5
I. Hyrja	8
II. Implementimi i planit aksional -	
Transparenca, llogaridhënia, proaktiviteti dhe inkluziviteti	10
III. Metodologjia dhe burimet	22
Aneksi I.	23
Pasqyra e implementimit të Transparencës, llogaridhënies, proaktivitetit dhe inkluzivitetit	23
Aneksi II.	26
Burimet/materialet për verifikim	26

LISTA E SHKURTESAVE

PNA 5	Plani i pestë nacional aksional për Partneritet për qeverisje të hapur
PPH	Partneritet për pushtet të hapur
NJVL	Njësitë e vetëqeverisjes lokale
SEPP	Sistemi elektronik për prokurime publike
NVAS	Numri i vetëm amë i subjektit
NVT	Numri i vetëm tatimor
UNDP	United Nations Development Programme (UNDP)

Ekzemplarin e këtij raporti e përpiloi Darko Antiq nga Shoqëria ESE në bazë të ekzemplarëve të raportit të MRP-së (mekanizmi për raportim të pavarur). Ekzemplari është përpiluar për përgatitje të raporteve, të cilat janë pjesë e procesit për vlerësim dhe monitorim të pavarur të Planit Aksional për PQH të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga përfaqësuesit e organizatave qytetare të cilat janë anëtare të Rrjetit Nacional të OQ-ve për PQH.



Association for emancipation,
Solidarity and equality
of women - ESE

REZYMEJA PËRMBLEDHËSE

Republika e Maqedonisë së Veriut -
Transparenca, llogaridhënia,
proaktiviteti dhe inkluziviteti



Transparenca aktive, hapja e institucioneve dhe komunave, si dhe rritja e qasjes së qytetarëve në informacione me karakter publik, duke përfshirë këtu edhe organizatat qytetare, janë elementet kryesore që gjenden në këtë raport. Në shumicën e angazhimeve është vënë re fillimi i tyre, përparimi i dukshëm apo realizimi i plotë i tyre, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me të dhënat e transparencës fiskale, si dhe vëllimin e informacionit në dispozicion të organizatave qytetare. Politikat dhe veprimet e institucioneve në shtet vazhdojnë të punojnë në drejtim të bashkëpunimit të hapur dhe përfshirjes së të gjithë aktorëve në proceset vendimmarrëse, veçanërisht nëpërmjet përfshirjes në grupe pune, proceseve konsultative, gjë që reflektohet edhe në shkallën e zbatimi i angazhimeve të përcaktuara në PNA 5 në fushën e prioritetit të parë. Përmirësimi apo përparimi më i madh është vërejtur në publikimin e të dhënave për organizatat qytetare, si dhe në pjesën e publikimit të informacioneve me karakter publik nga institucionet, ku vërehet një rritje, kështu që edhe 92% e institucioneve si posedues të informacioneve me karakter publik dorëzon raporte tek Agjencia për qasje të lirë tek informacionet të karakter publik, e cila, nga ana tjetër, i integron në raportet e veta. Në periudhën e mbetur pritet realizimi i plotë i angazhimeve të nisura, por të papërfunduara plotësisht, sepse bashkëpunimi i hapur dhe procesi konsultativ i të gjithë aktorëve është faktor kyç për realizimin e tyre, i cili duhet të merret parasysh në çdo proces më vete, sidomos kur flasim për hapje dhe transparencë të institucioneve.

PASQYRË E PËRGJITHSHME E FUSHËS PRIORITARE

Fusha prioritare është në rrugë të drejtë që të përparojë edhe më tej me realizimin e angazhimeve të përcaktuara, sepse nga 6 angazhime të ndryshme, 2 janë pothuajse plotësisht të realizuara dhe 2 të tjera janë në rrugë të mirë që të realizohen plotësisht deri në vitin e ardhshëm. Aty ku zbatimi është në fillim, fusha prioritare më shumë varet nga angazhimi i institucioneve për të arritur atë që kanë rënë dakord dhe janë përkushtuar në procesin e bashkëkrijimit të planit, siç është për shembull, vendosja e një butoni të vetëm për prokurimin publik nga të gjitha 80-të komunat ose publikimi i grupeve të të dhënave në format të hapur. Si “angazhim yll” mund të konsiderohet angazhimi me të cilin hapen të dhënat për organizatat qytetare në vend, kurse ku afër mund të vendoset edhe angazhimi për shpallje proaktive të informacioneve me karakter publik në ueb-faqet e institucioneve, ku raporte të tilla dorëzojnë 92% nga 1445 institucione posedues të informacioneve me karakter publik.

TABELA 1.

PASQYRË E SHPEJTË

Prioriteti ekziston nga: 2014

Periudha e implementimit, që është lëndë e raportimit: tetor 2021 - tetor 2022

Numri i angazhimeve në suazat e prioritetit: 6

ZHVILLIMI I PRIORITETIT

Niveli i hapjes dhe pjesëmarrjes: i hapur

Zëri i OQ-ve: ndikim i madh

Përfshirja e institucioneve publike: i madh

IMPLEMENTIMI

Angazhime të miratuara: #(%)

Angazhime të realizuara tërësisht: #(%)

Niveli i bashkëpunimit midis OQ-ve dhe institucioneve publike: i lartë

PESË REKOMANDIMET KRYESORE

Ato kanë për qëllim të informojnë zhvillimin e angazhimeve, të cilat janë pjesë e prioritetet që vlerësohet në planin e ardhshëm aksional dhe ta drejtojnë zbatimin e planit aktual aksional. Monitorimi rekomandon si më poshtë:

Implementim të plotë të angazhimit në lidhje me publikimin e të dhënave për pronarët realë, duke pasur parasysh se ato janë të disponueshme në njoftimet e kontratës së lidhur, kurse mund të shtohet edhe deklaratë shtesë në vetë dokumentacionin e tenderit për të publikuar pronarin real të firmës që do ta marrë atë tenderin.

Të përshpejtohet procesi i hapjes së të dhënave në komunat dhe të përshpejtohet edukimi i të punësuarve për menaxhimin e të dhënave të tilla, të cilat janë të një rëndësie të jashtëzakonshme për promovimin e transparencës dhe hapjes së komunave, nga e cila do të përfitojnë të gjithë aktorët, duke përfshirë edhe organizatat qytetare dhe vetë qytetarët.

Të krijohet një pjesë e veçantë (tab) për prokurimet publike në ueb-faqet e komunave dhe institucioneve, sepse të gjitha parakushtet për këtë janë përmbushur në PNA-të e mëparshme, kështu që tani mungon zbatimi, për të cilin ka nxjerrë përfundim edhe Qeveria, por atë e respektojnë vetëm 9% e institucioneve.

Institucionet ta ndjekin procesin e përdorimit të raporteve dinamike të organizatave qytetare që të përcaktohet sa do të japë efekt në realitet kjo pjesë e angazhimit dhe a nevojitet hapje e këtyre raporteve dinamike edhe për opinionin më të gjerë.

Të përshpejtohet procesi i zbatimit të angazhimit në lidhje me instalimin e tabelave elektronike dhe vendosjen e mekanizmave të unifikuar për përfshirjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse, si dhe vendosjen e të paktën një mjeti inovativ për qasje tek informacioni dhe inkurajimin e përfshirjes së qytetarëve në komuna.

PËR AUTORIN

Liljana Jonoski, mr. në shkencat juridike, drejtoreshë e përgjithshme e Koalicionit Rural, ka mbi 15 vjet përvojë pune në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural dhe është eksperte e profiluar me njohuri të thellë në proceset e reformës së administratës publike, si dhe përfshirjen e të drejtës së barazisë gjinore në jetën shoqërore dhe qasjen të shërbimeve publike me fokus mjediset rurale.





I. HYRJA

Partneriteti për qeverisje të hapur është iniciativë globale e cila i bashkon reformatorët e pushtetit dhe liderët e shoqërisë qytetare në krijimin e planeve aksionale që pushteti të jetë më inkluziv, më i përgjegjshëm dhe më llogaridhënës. Angazhimet e planit aksional në fushën prioritare **Transparenca, llogaridhënia, proaktivitet dhe inkluziviteti** mund të mbindërtohen mbi angazhimet ekzistuese, të identifikojnë hapa të rinj për realizimin e reformave aktuale ose të iniciojnë aksion në një fushë krejtësisht të re. Monitorimi i pavarur i angazhuar për përpilimin e këtij raporti zbatoi një sërë aktivitete për vlerësimin e implementimit të angazhimeve që të sigurohet se pushteti do të mbetet i përkushtuar në zbatimin e tyre. Liderët e shoqërisë qytetare dhe të pushtetit i përdorin këto evalvime që të reflektojnë mbi përparimin personal dhe të përcaktojnë se a ndikojnë aksionet e ndërmarra mbi jetën e njerëzve.

Republika e Maqedonisë së Veriut merr pjesë në PQH nga viti 2011 dhe deri më tani ka miratuar pesë plane aksionale. Plani i pestë aksional (2021 - 2023) e tejkalon ambicien e planeve të mëparshme, sidomos në lidhje me transparencën e prokurimeve publike, dërgimin e shërbimeve publike dhe qasjen te drejtësia për grupet vulnerabile. Zbatimi i tërësishëm i planit mund ta bëjë Republikën e Maqedonisë së Veriut

lidere rajonale në Ballkanin Perëndimor në fushat kryesore të qeverisjes së hapur dhe t'i adresojë prioritetet e procesit të aderimit në BE. Duke pasur parasysh spektrin dhe vëllimin e planit aksional, nevojitet bashkëpunim i ngushtë midis institucioneve publike dhe shoqërisë qytetare në arritjen e rezultateve të rëndësishme. Angazhimet e Planit të pestë aksional të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë organizuar në pesë fusha tematike: transparenca, antikorrupsioni, dërgimi i shërbimeve publike, qasja te drejtësia dhe mjedisi jetësor dhe aksionet klimatike. Angazhimet mbulojnë një numër të madh temash duke përfshirë edhe prokurimet publike, ndjekjen e paraqitjeve të gjendjes pronësore të funksionarëve publikë, integrimin e prioriteteve qytetare në dërgimin e shërbimeve publike dhe përforsimin e qasjes te ndihma juridike pa pagesë. Republika e Maqedonisë së Veriut po e zbaton edhe planin e saj të dytë për parlament të hapur dhe planin e parë aksional për gjyqësor të hapur për përforsim të transparencës së pushtetit gjyqësor.

Vlerësimin e bën monitoruesja e pavarur Liljana Jonoski, Koalicioni Rural, e cila e ka bërë këtë evalvim. Raporti ka për qëllim ta informojë dialogun aktual për zhvillim dhe zbatim të angazhimeve të ardhshme.

Ky raport e përfshin implementimin e angazhimeve në suazat e fushës Transparenca, llogaridhënia, proaktivitet dhe inkluziviteti nga plani i pestë aksional i Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2021 - 2023.

Realizimi efektiv i të drejtave dhe lirive të qytetarëve nëpërmjet zmadhimit të përgjegjësisë së institucioneve është një nga angazhimet themelore të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Domethënë, rritja e nivelit të transparencës ndikon pozitivisht në demokratizimin e shtetit dhe u mundëson qytetarëve që të kenë kontroll mbi institucionet. Gjithashtu, transparenca ka një efekt pozitiv në zhvillimin ekonomik të vendit, si dhe në aspiratat e tij euroatlantike. Ajo është komplementare me reformën në administratën publike dhe me arritjen e orientimit në shërbim të organeve publike. Duke theksuar transparencën aktive, kurse duke marrë parasysh trendet dhe proceset e reja të digjitalizimit që po ndodhin në botë, shoqëria qytetare në vend krijoi dhe më pas në vazhdimësi zbatoi Indeks të Transparencës Aktive ¹ në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Por, megjithatë, në raportin e fundit të Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut² shkruhet se kur bëhet fjalë për punën e organizatave qytetare dhe qytetarët nevojiten përpjekje për përmirësim të transparencës në krijimin e politikave dhe inkluzivitetit në proceset

konsultuese. Korniza juridike dhe financiare duhet të përmirësohen edhe më shumë dhe të zbatohen në praktikë. Paralelisht me konstatimin e tillë, në Planin nacional aksional 2021 - 2023 është paraparë prioriteti Transparenca, llogaridhënia, proaktiviteti dhe inkluziviteti, që mbindërtohet vazhdimisht nëpër planet e mëparshme nacionale aksionale dhe për periudhën e paraparë i përfshin këto angazhime:


- **1.1.** Shpallja publike e pronarëve të vërtetë të firmave që kanë lidhur marrëveshje për prokurime publike;
- **1.2.** Shpallje proaktive e informacioneve me karakter publik në ueb-faqet e institucioneve;
- **1.3.** Shpallje e informacioneve themelore për prokurimet publike në ueb-faqet e institucioneve;
- **1.4.** Përpëparimi i qasjes tek informacionet dhe numri i të dhënave të hapura të shpallura në njësitë e vetëqeverisjes lokale (NJVL);
- **1.5.** Mundësimi i qasjes pa pagesë të të dhënave për organizatat qytetare;
- **1.6.** Transparenca fiskale dhe llogaridhënia në nivel lokal dhe përmirësimi i përfshirjes së qytetarëve nëpërmjet mekanizmave dhe mjeteve inovative.

¹ <https://www.ccc.org.mk/images/stories/akt22.pdf>

² <https://www.sep.gov.mk/page/?id=1117#.Y3E6FHbMJPY>



II. ZBATIMI I PLANIT AKSIONAL - TRANSPARENCA, LLOGARIDHËNIA, PROAKTIVITETI DHE INKLUZIVITETI



2.1. PASQYRA E PLANIT AKSIONAL - TRANSPARENCA, LLOGARIDHËNIA, PROAKTIVITETI DHE INKLUZIVITETI

Me qëllim që të sigurojë mënyrë të sistematizuar të planifikimit dhe zbatimit të procesit të konsultimit, e cila do të sigurojë proces në kohë, pa pengesa, inkluziv dhe transparenten në bashkëkrijimin e PNA 2021-2023, në vitin 2020 është përcaktuar mënyra e zbatimit të procesit të bashkëkrijimit të PNA-së, si dhe procedura për zbatimin e konsultimeve me palët e prekura për krijimin e prioriteteve dhe angazhimeve të reja në suazat e procesit të PQH-së me kornizë kohore, është bërë thirrje publike për bashkëkrijim të PNA 5 dhe janë dhënë drejtimit për zbatimin e pyetësorit për vlerësim të implementimit të masave të PNA-së për PQH 2018-2020 dhe nevojën për përfshirjen e tyre në PAN 5 të ri.

Në mënyrë themelore në procedurë të paraparë dhe përkatëse të procesit të bashkëkrijimit, në shtator 2020, filloi procesi i përgatitjes së Planit të pestë nacional aksional 2021 – 2023 në të cilin, në përputhje me idetë dhe çështjet e reja të dhëna që duhet të përpunohen në këtë plan, u krye fuzion, rigrupim, por edhe zgjerim i spektrit të fushave prioritare për planin e ri aksional, kështu fusha e parë prioritare e mori emrin: Transparenca, llogaridhënia, proaktiviteti dhe inkluziviteti.

Gjatë zhvillimit të prioriteteve janë përfshirë përfaqësues të institucioneve: Regjistri qendror i RMV-së, Agjencia për qasje të lirë të informacionet me karkater publik, Byroja për prokurimet publike, Sekretariati i përgjithshëm i Qeverisë së RMV-së, si dhe Ministria e Vetëqeverisjes Lokale. Përveç institucioneve, organizatat qytetare që punojnë në këtë fushë janë përfshirë gjithashtu aktivisht në përcaktimin e angazhimeve në suazat e këtij prioriteti. Në përputhje me intervistat dhe konsultimet e kryera me anëtarët e grupeve të punës, nuk pati angazhime të cilat nuk janë pranuar, kurse niveli i bashkëpunimit dhe hapjes së institucioneve dhe organizatave qytetare është i lartë, që dëshmohet edhe nga përkushtimi dhe bashkëpunimi i të gjitha palëve të prekura, jo vetëm në procesin e përcaktimit të angazhimeve por edhe në procesin e zbatimit të tyre.

Nga angazhimet e përcaktuara në prioritetin e parë, me implementim të plotë karakterizohet një angazhim, ndërsa 2 nga angazhimet e përcaktuara dhe të miratuara mund të konsiderohen si implementim i theksuar. Zmadhimi i nivelit të hapjes dhe bashkëpunimit të përbashkët ndërmjet institucioneve dhe organizatave qytetare është faktor pozitiv që kontribuon në përparimin pozitiv në zbatim, ndërsa, nga ana tjetër, aty ku është vërejtur përparim i kufizuar, zakonisht vjen si pasojë e nevojës për ndryshime ligjore apo disa paqartësi në legjislacion, si dhe për shkak të procedurave të gjera të komunikimit ndërmjet vetë institucioneve.

Ndryshime të dukshme janë vërejtur veçanërisht në angazhimet në lidhje me promovimin e qasjes tek informacionet në lidhje me organizatat qytetare, si dhe në angazhimet në lidhje me publikimin dhe promovimin e qasjes në të dhënat e hapura, por duhet të shënohet edhe puna aktive të Agjencisë për qasje të lirë në informacione me karakter publik, si dhe puna e Regjistrisë qendror dhe Byrosë së prokurimeve publike si institucione që i përkushtohen veçanërisht realizimit të angazhimeve që janë pjesë e PNA 5 dhe që i kanë përcaktuar së bashku me organizatat e shoqërisë qytetare nëpërmjet një qasjeje të hapur bashkëpunimi, e cila vazhdon në pjesën e zbatimit të tyre.

Si angazhim yjor mund të konsiderohet angazhimi për mundësim të qasjes së lirë në të dhëna për organizatat qytetare, i cili është zbatuar plotësisht dhe përmirësimi apo zgjerimi i të cilit është planifikuar për planin e ardhshëm aksional. Transparenca fiskale dhe llogaridhënia në nivel vendor në periudhën në vijim mund të konsiderohet gjithashtu si një nga angazhimet e jashtëzakonshme, që pritet të jetë mjaft i suksesshëm, sepse është përfshirë edhe bashkësia e donatorëve në zbatimin e tij. Domethënë, në kuadër të këtij angazhimi, tabelat elektronike tashmë janë instaluar në 18 komuna, ndërsa në 4 komuna të tjera do të vendosen deri në fund të këtij viti, kështu që ky angazhim vazhdon që nga PNA-ja e kaluar dhe deri në fund të kësaj periudhe transparenca fiskale do të përmirësohet në 40 komuna. Forumet në bashkësi tashmë janë përcaktuar si mekanizëm për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse, i cili pritet të vendoset në rreth 40 komuna dhe ky përkushtim ka marrë vendin e tretë në nivel botëror në fushën e promovimin e transparencës dhe llogaridhënies.



2.2. ANGAZHIME

I. Shpallja publike e pronarëve të vërtetë të firmave që kanë lidhur marrëveshje për prokurime publike



RAPORTI PËR DIZAJNIN	RAPORTI PËR IMPLEMENTIMIN
1. Angazhimi është zhvilluar nëpërmjet procesit të hapur dhe konsultues me pjesëmarrje të palëve të prekura relevante: PO / JO	1. Statusi i implementimit: I përfunduar / i kufizuar / nuk ka filluar
2. Angazhimi është relevant për PQH-në: PO / JO qasje tek informacionet, pjesëmarrje qytetare, llogaridhënie publike	2. Angazhimi ka sjellë ndryshime në sektorin publik: PO / JO

Më 27 janar 2021, në RMV u krijua Regjistri i pronarëve përfitues, me qëllim të rritjes së transparencës në strukturën e pronësisë së personave juridikë dhe përmbushjes së standardeve ndërkombëtare dhe standardeve të BE-së për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Transparenca e të dhënave nga ky regjistër mundëson lidhjen e të dhënave me atë se kush e posedon personin juridik, kush e kontrollon dhe kush përfiton përfundimisht prej tij. Kjo ndihmon në parandalimin e korrupsionit, zvogëlimin e rreziqeve të investimeve dhe rritjen e menaxhimit të mirë.

Angazhimi përfshin shpallje publike të informacionit për pronarët realë të kompanive që kanë lidhur kontrata për prokurime publike në Sistemin elektronik të prokurime publike, në pjesën ku publikohet Njoftimi për kontratën e lidhur dhe Marrëveshja për prokurime publike. Në këtë mënyrë do të parandalohet edhe më tej korrupsioni, pra do të parandalohet që paratë publike të përfundojnë në xhepat privat të zyrtarëve, zyrtarëve dhe do të parandalohen marrëveshjet e paligjshme të firmave në prokurimet publike. Nga ana tjetër, publikut do t'i mundësohet ndjekje e racionalitetit të shpenzimit të parave publike, përgjegjësia, si dhe ndezja e alarmit kur zbulon të a.q. dritat e kuqe në korrupsion³.

Zbatimi i këtij angazhimi do të përkufizohej si i kufizuar, sepse është arritur një marrëveshje për kriteret se për cilat kontrata do të publikohen pronarët realë, zgjidhja teknike për shkarkimin dhe publikimin e të dhënave ndërmjet Byrosë së prokurimet publike dhe Regjistrin qendror. është përgatitur, por këtu zbatuesit përballohen me sfidën e parë, nëse publikimi i të dhënave për pronarët realë është në përputhje me suazat ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale apo jo. Për momentin është dërguar një kërkesë për mendim në

³ https://ovp.gov.mk/wp-content/uploads/2021/07/NAP5-PARTNERSTVO-ZA-OTVORENA-VLAST-2021-2023-_potvrdenod-Vlada-26.10.2021.pdf

Agjencinë për mbrojtjen e të dhënave personale që të deklarohet në lidhje me këtë pjesë dhe më pas do të bëhet e mundur përfundimi i plotë i angazhimit, pra pronarët e vërtetë nëpërmjet informimit për marrëveshje të lidhur do të publikohen në sistemin elektronik të prokurimeve publike.

Zbatimi i angazhimit është arritur deri në shkallën e realizimit të hapit të fundit që të ndihen përfitimet e tij, si në drejtim të hapjes së pushteteve dhe rritjes së transparencës, ashtu edhe në fushën e parandalimit dhe uljes së korrupsionit në prokurimet publike. Për momentin janë plotësuar të gjitha parakushtet për zbatimin e angazhimit, ndërkohë që nuk ka rezultate të hershme të zbatimit të zotimit sepse nevojitet realizimi i plotë i tij që të ketë ndikim në shoqëri dhe të kontribuojë drejtpërdrejt në zgjidhjen e problemi publik që po trajtohet në angazhim sepse bëhet fjalë për një grup të ri të dhënash dhe informacionesh që nuk kanë qenë të disponueshme për publikun e gjerë dhe qytetarët.

Zbatimi i plotë i angazhimit do të hapë autoritetet sepse bëhet fjalë për futjen e një praktike të re që do të kontribuojë në parandalimin e korrupsionit, përmirësimin e qasjes së qytetarëve në informacion, që do të jetë falas, si dhe do të përmirësohen mundësitë për pjesëmarrjen e organizatave qytetare në proceset e marrjes së vendimeve sepse do të bëhet e mundur zbulimi i veprimeve korruptive kur bëhet fjalë për prokurimet publike, kurse do të rritet njëkohësisht llogaridhënia publike, sepse krijon dhe përmirëson rregullat, normativat dhe mekanizmat për llogaridhënien publike të funksionarëve. Deri në këtë moment kjo nuk ka ndodhur për shkak se angazhimi ende nuk është realizuar plotësisht, pra pronarët e vërtetë të kompanive që marrin prokurime publike ende nuk janë shpallur publikisht për shkak të sfidave me normativën ligjore në pjesën e mbrojtjes së të dhënave personale.

II. Shpallja proaktive e informacioneve me karakter publik në ueb-faqe e institucioneve

RAPORTI PËR DIZAJNIN	RAPORTI PËR IMPLEMENTIMIN
1. Angazhimi është zhvilluar nëpërmjet procesit të hapur dhe konsultues me pjesëmarrje të palëve të prekura relevante: PO / JO	1. Statusi i implementimit: I përfunduar / i kufizuar / nuk ka filluar
2. Angazhimi është relevant për PQH-në: PO / JO qasje tek informacionet, pjesëmarrje qytetare, llogaridhënie publike	2. Angazhimi ka sjellë ndryshime në sektorin publik: PO / JO

Angazhimi ka të bëjë me promovimin e të a.q. transparencë aktive dhe rritje të vëllimit të informacionit publik që institucionet do t'i publikojnë vetë pa qenë nevoja të paraqesin kërkesë për qasje të lirë në informacionet me karakter publik. Angazhimi përfshin përpjekjet e intensifikuara të Agjencisë për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë tek informacionet me karakter Publik për të përmirësuar transparencën aktive midis poseduesve të informacionit, pritjet që realizimi i këtij angazhimi të sjellë rritjen e disponueshmërisë së informacionit nga institucionet ndaj qytetarëve, gjë që nga njëra anë do të ulë presionin ndaj institucioneve duke paraqitur kërkesa për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, por nga ana tjetër do të mundësojë pjesëmarrjen efektive të qytetarëve në krijimin e politikave, si dhe përparimin e cilësisë së shërbimeve dhe informacionit që qytetarët marrin nga institucionet shtetërore ⁴.

Zbatimi i këtij angazhimi mund të përkufizohet si i përfunduar, edhe pse është proces që do të zhvillohet në vazhdimësi deri në përfundimin e zbatimit të PNA 5, e më tej, sepse raportet vjetore me të dhëna të përfshira për mbajtësit e informacionit, institucionet në nivel nacional dhe lokal do të publikohet çdo vit. Për vitin 2021 është publikuar raporti vjetor për poseduesit e informacionit, ku ka një rubrikë të veçantë për raportet vjetore të poseduesve të informacionit, kështu që për vitin 2021 madje 1334 institucione nga gjithsej 1,445 posedues të informacioneve me karakter publik ose 92,32% e kanë respektuar obligimin për dorëzimin e raporteve vjetore në Agjenci me kohë. Në raport konstatohet edhe trendi i rritjes së numrit të poseduesve të informacioneve që dorëzojnë raporte me kohë, kështu që nëse në vitin 2020 nuk kanë dorëzuar raporte 299 institucione, në vitin 2021 ky numër është vetëm 111, që flet për efektivitetin dhe efikasitetin e dispozitave penale, të cilat zbatohen me Ligj, gjë që është vërtetuar edhe nëpërmjet intervistave me të punësuarit në Agjenci. ⁵ Me vetë faktin se në raportin e Agjencisë për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik publikohen informacione përmbledhëse për raportet vjetore të poseduesve të informacionit publik, si dhe rritjen e numrit të institucioneve që kanë dorëzuar raporte, ky angazhim mund të konsiderohet i realizuar plotësisht, kurse dëshmitë janë të dukshme në raportin vjetor të Agjencisë për vitin 2021, si dhe në të dhënat e hapura të publikuara për poseduesit e informacioneve në linkun e mëposhtëm: <https://aspi.mk/%d0%b4%d0%be%d0%ba%d1%83%d0%bc%d0%b5%d0%bd%d1%82%d0%b8/%d0%b3%d0%be%d0%b4%d0%b8%d1%88%d0%bd%d0%b8-%d0%b8%d0%b7%d0%b2%d0%b5%d1%88%d1%82%d0%b0%d0%b8/>

Zbatimi me sukses i angazhimit është falë angazhimit të institucioneve, por edhe detyrimit ligjor për dorëzimin e raporteve vjetore, si dhe zbatimit të sanksioneve penale, që nga ana tjetër kontribuon drejtpërdrejt që të rritet numri i mbajtësve të informacionit që dorëzojnë raporte në Agjenci. Nga ana tjetër, hapja e bashkëpunimit të Agjencisë me organizatat qytetare, si dhe puna e përbashkët në krijimin dhe zbatimin e angazhimit kontribuon drejtpërdrejt në zbatimin e tij të suksesshëm. Rezultatet e zbatimit të angazhimit do të shihen nëpërmjet raportit vjetor të Agjencisë për vitin 2022, dhe kjo në numrin e kërkesave të paraqitura pranë institucioneve, kohën e përgjigjes së tyre etj. Nëpërmjet përpilimit dhe publikimit të këtillë të raporteve nga institucionet, qytetarëve dhe organizatave qytetare do

⁴ <https://dzm.mk/mk/210706-50-od-opshnitine-na-veb-portalite-nemaat-soodvetni-informacii>

⁵ https://aspi.mk/wp-content/uploads/2022/04/%D0%93%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D1%88%D0%B5%D0%BD-%D0%B8%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98_MK.pdf

t'u mundësohet mbikëqyrje më e madhe në shkallën e publikimit të informatave themelore nga institucionet, duke rritur kështu presionin ndaj institucioneve që të publikojnë më shumë informacione.

Zbatimi i këtij angazhimi “i hap autoritetet” në çdo rast sepse sipas raportit të Agjencisë për vitin 2021 nëse në vitin 2016 para se të fillonte puna serioze në këtë fushë mesatarja e publikimit të informacionit ishte 45%, sot është 92%.⁶ Me realizimin e këtij angazhimi, institucionet rritin vëllimin e informacioneve për vendimet që marrin, zbulohen informacione nëpërmjet të cilave qytetarët mund të kërkojnë përgjegjësi nga institucionet, por publikohen edhe informacione për shërbimet që i përdorin dhe kanë nevojë qytetarët. Nga ana tjetër, vetë institucionet promovojnë parimin e mirëqeverisjes dhe integritetit, institucioni bëhet më i përgjegjshëm në shpenzimin e parave publike dhe është më efikas në menaxhimin e informacioneve që i disponon. Ky angazhim kontribuon ndaj transparencës, sepse përmirëson qasjen në informacionet publike, por edhe cilësinë e tyre, mandej është i rëndësishëm për pjesëmarrjen qytetare, sepse në këtë mënyrë përmirësohen kushtet dhe mundësitë për pjesëmarrjen publike dhe ndikim në proceset e krijimit të politike dhe marrjen e vendimeve publike, kurse kontribuon gjithashtu në përmirësimin e llogaridhënies publike, pasi përmirëson rregullat, normativat dhe mekanizmat për llogaridhënien publike të funksionarëve.

III. Shpallja e informacioneve themelore për furnizimet publike në ueb-faqet e institucioneve

RAPORTI PËR DIZAJNIN	RAPORTI PËR IMPLEMENTIMIN
1. Angazhimi është zhvilluar nëpërmjet procesit të hapur dhe konsultues me pjesëmarrje të palëve të prekura relevante: PO / JO	1. Statusi i implementimit: I përfunduar / i kufizuar / nuk ka filluar
2. Angazhimi është relevant për PQH-në: PO / JO qasje tek informacionet, pjesëmarrje qytetare, llogaridhënie publike	2. Angazhimi ka sjellë ndryshime në sektorin publik: PO / JO

Ky angazhim po përmirësohet, pra po krijohen kushte për realizimin e tij edhe në dy PNA-të e mëparshme dhe problemi kryesor që trajton është përqindja e ulët e informimit të qytetarëve për prokurimet publike të institucioneve dhe shpenzimin e parave publike. Të dhënat për prokurimet publike janë plotësisht të disponueshme në Sistemin elektronik të prokurimeve publike, por pothuajse asnjë qytetar i zakonshëm e përdor këtë sistem. Në

⁶ https://aspi.mk/wp-content/uploads/2022/04/%D0%93%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D1%88%D0%B5%D0%BD-%D0%B8%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98_MK.pdf

përputhje me hulumtimet e Qendrës për Komunikime Qytetare, rreth 98% e mbi 400 të anketuarve që kanë informacion për prokurimin publik të institucioneve janë përgjigjur se i kanë marrë nga ueb-faqet e institucioneve apo të komunave.⁷ Pikërisht ky është edhe qëllimi kryesor i angazhimit, nëpërmjet qasjes të informacionet për prokurimet publike në faqet e internetit të institucioneve që të zmadhohet ndërgjegjësimi i qytetarëve për këto procedura, gjë që do të sigurojë qasje të lehtë, të shpejtë, të thjeshtë dhe të kuptueshëm në këto lloje informacionesh.

Kur flasim për zbatimin e këtij angazhimi në përputhje me intervistat me përfaqësuesit e institucioneve anëtare të grupit punues, më 19.4.2022 Qeveria në një seancë ka miratuar një konkluzion me të cilin ka obliguar të gjitha institucionet në afat prej 15 ditësh që të vendosin një buton të posaçëm për prokurimet publike, i cili do të përmbajë informacionin e përfshirë në angazhim, domethënë planin vjetor të prokurimeve publike me të gjitha ndryshimet dhe shtesat e tij, njoftimet për prokurimet publike (lidhja nga publikimi i SLPP-së), njoftimet e kontratat e lidhura (lidhja nga shpallja e SLPP-së), kontratat e lidhura dhe njoftimet për kontratat e zbatuara (lidhja nga njoftimi i SLPP-së)⁸. Në përputhje me të dhënat nga intervista me përfaqësuesen e Qeverisë së RMV-së, vetëm 120 institucione prej 1332 kanë vepruar sipas këtij konkluzionin. Sfidë shtesë në zbatimin e këtij angazhimi është se kur bëhet fjalë për komunat, Qeveria vetëm mund t'u rekomandojë që ta vendosin një buton të tillë dhe nuk ka asnjë mekanizëm për ta bërë atë të detyrueshëm. Sipas synimeve të përcaktuara në angazhim, ku të paktën 50% e institucioneve duhet të kenë një buton të tillë dhe të raportojnë për prokurimet publike, deri më tani kjo përqindje arrin në vetëm 9%, prandaj zbatimi i këtij angazhimi konsiderohet i kufizuar gjatë periudhës së monitorimit.

Rezultate të hershme nga zbatimi i këtij angazhimi nuk ka sepse është ende në periudhën e zbatimit. Një nga faktorët që ka ndikuar në zbatimin e dobët të zotimit është se obligimi për një buton të detyrueshëm për prokurimet publike në faqet e internetit të institucioneve është dhënë në formë rekomandimi dhe konkluzioneve të arritura në seancë të Qeverisë sipas të cilat duhet të veprojnë institucionet, por nuk ka as monitorim të parashikuar dhe as sanksione për ata që nuk e bëjnë këtë. Përveç kësaj, si faktor kufizues në realizimin e këtij angazhimi është fakti se Qeveria mund t'u japë vetëm rekomandim komunave, e jo t'i obligojë që ta përmbushin obligimin.

Angazhimi do t'i "hapë autoritetet" në një nga fushat më të ndjeshme të punës, përkatësisht në prokurimet publike, pra shpenzimin e parasë publike, por vetëm nëse mundësohet zbatimi i plotë i tij ose të paktën në 50% të institucioneve, që është të vendosur si synim në kuadër të këtij angazhimi. Monitorimi i mëtejshëm i PNA-së do të përcaktojë se sa përqindje realizimi do të arrihet, duke qenë se tani është vetëm 9%. Angazhimi është i rëndësishëm për transparencën, sepse u jep qytetarëve qasje në informacione të reja dhe e përmirëson cilësinë e informacioneve në dispozicion për ta. Angazhimi është i rëndësishëm

⁷ https://ovp.gov.mk/wp-content/uploads/2021/07/NAP5-PARTNERSTVO-ZA-OTVORENA-VLAST-2021-2023_-_potvrdenod-Vlada-26.10.2021.pdf

⁸ <https://vlada.mk/2022-40>

edhe për pjesëmarrjen qytetare, sepse përmirëson mundësinë dhe kushtet për pjesëmarrje dhe ndikim të publikut në proceset vendimmarrëse, kurse i përmirëson njëkohësisht rregullat, normativat dhe mekanizmat për llogaridhënien publike të institucioneve dhe funksionarëve.

IV. Përparimi i qasjes tek informacionet dhe i numrit të të dhënave të hapura të shpallura në njësitë e vetëqeverisjes lokale (NJVL)

RAPORTI PËR DIZAJNIN	RAPORTI PËR IMPLEMENTIMIN
1. Angazhimi është zhvilluar nëpërmjet procesit të hapur dhe konsultues me pjesëmarrje të palëve të prekura relevante: PO / JO	1. Statusi i implementimit: I përfunduar / i kufizuar / nuk ka filluar
2. Angazhimi është relevant për PQH-në: PO / JO qasje tek informacionet, pjesëmarrje qytetare, llogaridhënie publike	2. Angazhimi ka sjellë ndryshime në sektorin publik: PO / JO

Transparenca dhe hapja e NJVL-ve janë ende në nivele të ulëta, sepse një numër i madh komunash nuk publikojnë të dhënat që është detyrimi i tyre ligjor, si dhe përqindja e qytetarëve por edhe e zyrtarëve publikë që i njohin kushtet e të dhënave të hapura dhe përfitimet nga përdorimi i tyre. Është e nevojshme të sigurohet qasje më e lehtë në informacionet për funksionimin e pushtetit lokal, të inkurajohet përjasja gjithëpërfshirëse në procesin e vendimmarrjes dhe të publikohen më shumë të dhëna në një format të hapur, që është edhe qëllimi kryesor i këtij angazhimi. Kuptimi më i mirë i konceptit të të dhënave të hapura në nivel lokal, si dhe rritja e ndërgjegjësimit për përfitimet nga përdorimi i tyre, janë qëllimet kryesore për të cilat qëndron ky angazhim.

Zbatimi i këtij angazhimi konsiderohet i kufizuar sepse është realizuar vetëm një pjesë e tij, përkatësisht komunat marrin pjesë në hulumtimin e Fondacionit Metamorfozis për vitin 2021, kur është përgatitur raporti për Indeksën e hapjes së komunave, i cili është 25% në mesatare. Komunat me indeksin më të lartë të hapjes janë: Ohri (51%), Vasilevo (48%) dhe Koçani (48%), ndërsa më e ulëta renditet Plasnica me vetëm 3%⁹. 2 segmentet e tjera të angazhimit, pra zbatimi i trajnimeve për të punësuarit në komuna për menaxhimin e grupeve të të dhënave në format të hapur, si dhe minimumi i publikuar prej 5 grupesh të dhënash me format të hapur në 30 komuna do të realizohen deri në fund të zbatimit të PNA 5 në përputhje me deklaratat e anëtarëve të grupit të punës që u intervistuan në kuadër të monitorimit.

⁹ https://metamorphosis.org.mk/aktivnosti_arhiva/indeks-na-otvorenost-na-lokalnata-samouprava-2021-godina/

Rezultate të hershme të zbatimit të angazhimit nuk ka sepse nuk është realizuar plotësisht, veçanërisht në pjesën kryesore të tij sepse rezultatet e zbatimit të angazhimit do të jenë të dukshme pas futjes së të dhënave të hapura në 30 komuna, siç thuhet në angazhim, i cili nga ana tjetër duhet të rezultojë me një indeks të rritur të hapjes së atyre komunave, gjë që do të shihet në raportin për vitin 2022 dhe më tej. Sipas deklaratave të të intervistuarve, hapja ndaj bashkëpunimit me komunat, si dhe përkushtimi i tyre për promovimin e transparencës dhe hapjes, konsiderohen si faktor kyç për realizimin e suksesshëm të angazhimit, por duhet të merren parasysh edhe kapacitetet teknike dhe burimet njerëzore në dispozicion të tyre, veçanërisht komunat më të vogla, që nga ana tjetër është një nga faktorët e zbatimit të dobët të angazhimit.

Angazhimi do t'i "hapë autoritetet" pas zbatimit të plotë të tij, sepse po futen praktika të reja në funksionimin e pushteteve lokale dhe hapja e një sasive të madhe të dhënash që jo vetëm do të jenë në format të hapur, por edhe do të kontribuojnë drejtpërdrejt, në njëra anë do të rritet ndërgjegjësimi dhe mundësia e qytetarëve për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse dhe nga ana tjetër do të ulët presioni mbi vetë komunën, si me kërkesa për qasje të lirë në informacione të karakterit publik, ashtu edhe në aspektin e cilësisë së informacionit të ofruar nga komuna dhe efikasitetit dhe efektivitetit të tij në shërbim të qytetarëve.

V. Mundësimi i qasjes pa pagesë të të dhënave për organizatat qytetare

RAPORTI PËR DIZAJNIN	RAPORTI PËR IMPLEMENTIMIN
1. Angazhimi është zhvilluar nëpërmjet procesit të hapur dhe konsultues me pjesëmarrje të palëve të prekura relevante: PO / JO	1. Statusi i implementimit: I përfunduar / i kufizuar / nuk ka filluar
2. Angazhimi është relevant për PQH-në: PO / JO qasje tek informacionet, pjesëmarrje qytetare, llogaridhënie publike	2. Angazhimi ka sjellë ndryshime në sektorin publik: PO / JO

Programet, institucionet apo donatorët e ndryshëm formojnë adresarë të ndryshëm të organizatave qytetare me lloje të ndryshme të dhënash që janë në dispozicion të tyre dhe të cilat i mbledhin mbi baza të ndryshme. Momentalisht, ekziston mundësia e kërkimit të organizatave qytetare pa kompensim financiar në faqen e Regjistrimit qendror me të dhënat e mëposhtme: NVAS, NVT, emri i plotë, emri i shkurtuar, data e themelimit, forma juridike, statusi juridik, adresa, si dhe si informacion shtesë (në falimentim/në likuidim), aktiviteti dhe madhësia mbizotëruese, por nuk ka të dhëna për themeluesit, personat e autorizuar, qëllimet dhe fushat e veprimtarisë etj. Nevoja për krijimin e regjistrave të veçantë, pra

bazave të të dhënave në format të hapur, lind për shkak të mungesës së qasjes në të dhëna të hapura për organizatat e shoqërisë qytetare në Regjistrin qendror të RMV-së, kurse të cilat përdoruesit do të mund t'i kërkojnë në baza dhe kategori të ndryshme.

Zbatimi i këtij angazhimi konsiderohet thuajse i përfunduar për shkak se është publikuar një listë e të dhënave për organizatat qytetare në një format të hapur e cila përditësohet çdo muaj dhe që është një nga arritjet kryesore që përmirëson mjedisin mundësues në të cilin punojnë organizatat qytetare. Lista është në dispozicion në: <https://www.crm.com.mk/mk/otvoreni-podatotsi/gragjanski-organizatsii>, ku janë vendosur të dhëna për 14 685 organizata qytetare. Mandej, si segmente të zbatimit të angazhimit është përditësimi i listës, që siç na thanë nga Regjistri Qendror, bëhet në baza mujore, më pas u formua një grup pune ndërmjet institucioneve dhe Sekretariatit të përgjithshëm të Qeverisë, si dhe Njësisë për bashkëpunim me organizatat joqeveritare për përgatitjen e formateve dinamike të raporteve që mund të përdoren nga institucionet. Raporte të tilla tashmë janë në dispozicion për institucionet, kurse po mbahen trajnime për nëpunësit shtetërorë për përdorimin e raporteve të tilla dinamike për organizatat qytetare. Ndoshta si faktor kufizues në rezultatet e zbatimit të angazhimit, përkatësisht sa do të përdoren raporte të tilla dinamike nga ta, është interesimi i dobët i nëpunësve shtetërorë për trajnime, por edhe nevoja për nënshkrimin e një memorandumi bashkëpunimi ndërmjet institucioni dhe Regjistri qendror në mënyrë që institucioni dhe zyrtarët të kenë qasje në raportet e tilla dinamike.

Si faktorë që kanë kontribuar në realizimin me sukses të këtij angazhimi në pjesën më të madhe të tij janë hapja dhe përkushtimi në punën e institucioneve së bashku me organizatat e shoqërisë qytetare. Interesi i përbashkët është perceptuar dhe pjesa më e madhe e angazhimit është zbatuar në favor të tij. Rezultatet e hershme të zbatimit nuk janë të dukshme, ndonëse ato sigurisht janë të pranishme, duke pasur parasysh se tani vetë organizatat qytetare dhe institucionet dhe komuniteti i donatorëve kanë njohuri për qëllimin dhe llojin e organizatave qytetare që ka shoqëria jonë, kështu që ato mund të përdoren për të krijuar partneritete, konsultime, etj. Si faktor për realizimin e dobët të angazhimit në një pjesë është pyetja se sa do të kenë interes nëpunësit dhe institucionet për shfrytëzimin e raporteve të tilla dinamike, kurse në këtë periudhë për shkak po mbahet trajnimi për nëpunësit shtetërorë, nuk është ende në dispozicion numri për raportet e ndërmarra nga institucionet.

Angazhimi është i rëndësishëm sepse promovon transparencën e shoqërisë qytetare dhe nuk lidhet drejtpërdrejt me praktikën e hapjes së institucioneve, por mundëson qasjen e hapur të të dhënave për organizatat qytetare. Në këtë mënyrë, përmirësohet cilësia dhe qasja në informacionin falas dhe publik që disponohet në një vend qendror dhe përveç kërtimeve individuale, mundësohet edhe përdorimi i të dhënave në mënyrë analitike, gjë që gjithashtu lehtëson barrën administrative të organizatave kur aplikojnë për burimet financiare publike dhe private donatore. Gjithashtu, nëpërmjet zbatimit të këtij angazhimi rriten edhe mundësitë për pjesëmarrjen e qytetarëve, sepse institucionet kanë qasje në të dhëna sipas të cilave mund të bëjnë një hartë tematike, gjeografike, tipike dhe të llojit tjetër të organizatave qytetare, me qëllim përfshirjen e tyre në proceset e krijimit dhe monitorimit të politikave publike.

VI. Transparenca fiskale dhe llogaridhënia në nivel lokal dhe përmirësimi i përfshirjes së qytetarëve nëpërmjet mekanizmave dhe mjeteve inovative

RAPORTI PËR DIZAJNIN	RAPORTI PËR IMPLEMENTIMIN
1. Angazhimi është zhvilluar nëpërmjet procesit të hapur dhe konsultues me pjesëmarrje të palëve të prekura relevante: PO / JO	1. Statusi i implementimit: I përfunduar / i kufizuar / nuk ka filluar
2. Angazhimi është relevant për PQH-në: PO / JO qasje tek informacionet, pjesëmarrje qytetare, llogaridhënie publike	2. Angazhimi ka sjellë ndryshime në sektorin publik: PO / JO

Qeverisja e mirë në nivel lokal nënkupton përmirësim të proceseve në funksion të dërgimit më efektiv dhe më ekonomik të shërbimeve publike, me sigurim të transparencës dhe llogaridhënies së tërësishme, si dhe përfshirjen e qytetarëve në marrjen e vendimeve. Nevoja për ngritjen e nivelit të transparencës dhe llogaridhënies në nivel lokal theksohet pothuajse në të gjitha raportet dhe dokumentet strategjike të institucioneve nacionale, kurse përparim në këtë fushë vërehet edhe nëpërmjet hulumtimit të opinionit publik mbi kënaqësinë nga shërbimet në nivel lokal, si dhe për njohjen e qytetarëve për disponueshmërinë e informacionit dhe për mënyrën se si shpenzohen mjetet buxhetore në komunën e tyre. Në dhjetor të vitit 2020, Qeveria miratoi një konkluzion që ngarkonte ministritë të përmirësojnë transparencën e tyre aktive, me theks të veçantë në transparencën financiare, veçanërisht në zbatimin e fondeve buxhetore. Në të njëjtën seancë obligimin e tillë për ministritë, Qeveria e rekomandon edhe për komunat.

Qëllimi Synimi i angazhimit që është harmonizuar ndërmjet institucioneve dhe organizatave qytetare është përcaktuar që nëpërmjet futjes së mekanizmave dhe mjeteve inovative do të kontribuohet drejtpërdrejt në përmirësimin e transparencës fiskale dhe llogaridhënies së njësisive të vetëqeverisjes lokale dhe përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje në nivel lokal.

Zbatimi i këtij angazhimi duhet të përfundojë në 10 komuna në përputhje me deklaratat në intervistat e përfaqësuesve të UNDP-së dhe Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale deri në fund të këtij viti, përkatësisht do të vendosen tabela elektronike në bazë të shembujve pozitivë nga faza e mëparshme në realizimin e projektit me mbështetjen e UNDP-së, ku në 18 komuna ka tabela të tilla, ndërsa në 6 të tjera do të vendosen me iniciativë të tyre, ku edhe kjo nismë ka marrë vendin e tretë në nivelin botëror si iniciativa për PHQ në nivel lokal. Si mjet i përbashkët që do të përdoret për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse në nivel lokal nëpërmjet përfaqësimit të duhur me theks në grupet vulnerabile dhe të marginalizuara të qytetarëve në 20 komuna, janë zgjedhur forumet e bashkësisë, mandej është planifikuar që në 40 komuna gjithsej të realizohen forume të tilla nëpër bashkësi si mekanizma të rregullt për konsultim të qytetarëve me komunat.

Nga ky angazhim nuk janë të dukshme “rezultatet e hershme”, sepse zbatimi i tij është në fillim, duke pasur parasysh se është vazhdimësi e një projekti të udhëhequr nga UNDP-ja, e cila në fazën e mëparshme ka siguruar tabela për gjithsej 18 komuna. Megjithatë, nga ajo që ishte themeluar më parë, tabelat e tilla kontribuojnë në përmirësimin e vetëdijes së qytetarëve për transparencën fiskale të komunave, ku qytetarët, si dhe anëtarët e Këshillit dhe të punësuarit marrin informacion lehtësisht të kuptueshëm që u mundëson atyre të angazhohen aktivisht në procesi i marrjes së vendimeve. Realizimi me sukses i këtij angazhimi garantohet nga fakti se realizimi i tij mbështetet nga bashkësia e donatorëve dhe futja e mekanizmit të forumeve në bashkësi garantohet duke financuar një pjesë të prioritetëve të votuara, të cilat mund të konsiderohen edhe si faktor që kontribuon në realizimin e suksesshëm të angazhimit.

Angazhimi në përputhje me rezultatet dhe zbatimin e PNA-së së mëparshme kontribuon theksueshëm në “hapjen”, veçanërisht të pushtetit lokal, që siguron qasje të shtuar të qytetarëve në informacionet me karakter publike, por ajo që është më e rëndësishmja, ka të bëjë me informacionin që është lehtësisht qasshëm, kurse njëkohësisht është i kuptueshëm për qytetarin e thjeshtë, pikërisht në fushën e transparencës fiskale. Në këtë mënyrë përmirësohet mundësia e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e marrjes së vendimeve dhe në krijimin e buxhetit të komunave.



III. METODOLOGJIA DHE BURIMET

Informacionet për këtë raport janë marrë në bazë të metodologjisë në vijim:

Konsultimi i dokumenteve dhe strategjive që lidhen me prioritetin të cili i kushtohet ky raport, si:

- Strategjia për transparencën e Qeverisë së RMV-së (2019 - 2021) - https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/strategji/strategjia_za_transparentnost_mk.pdf; Strategji për reforma të administratës publike (2018 - 2022) - <https://mioa.gov.mk/?q=mk/node/1587>
- Ligji për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik- <http://www.ippo.gov.mk/docs/xFiles/articles/zakonZaSlobodenPristapDoInfo/zakonZaSlobodenPristapDoInfo.pdf>
- Raporti i Komisionit Evropian për përparimin e Maqedonisë së Veriut për vitin 2021 - <https://www.sep.gov.mk/page/?id=1117#.Y3E6FHbMJPY>
- Analiza e zbatimit të Ligjit për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik me rekomandime për përparim të sistemit për qasje të lirë tek informacionet – <https://aspi.mk/wp-content/uploads/2022/10/%D0%90%D0%BD%D0%B0%D0%BB%D0%B8%D0%B7%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D0%BF%D1%80%D0%B8%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D0%97%D0%A1%D0%9F%D0%98%D0%88%D0%9A-%D1%81%D0%BE-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D0%BF%D0%BE%D1%80%D0%B0%D0%BA%D0%B8-%D0%B7%D0%B0-%D1%83%D0%BD%D0%B0%D0%BF%D1%80%D0%B5%D0%B4%D1%83%D0%B2%D0%B0%D1%9A%D0%B5-%D0%BD%D0%B0-%D1%81%D0%B8%D1%81%D1%82%D0%B5%D0%BC%D0%BE%D1%82-%D0%B7%D0%B0-%D1%81%D0%BB%D0%BE%D0%B1%D0%BE%D0%B4%D0%B5%D0%BD-%D0%BF%D1%80%D0%B8%D1%81%D1%82%D0%B0%D0%BF-%D0%B4%D0%BE-%D0%B8%D0%BD%D1%84%D0%BE%D1%80%D0%BC%D0%B0%D1%86%D0%B8%D0%B8%D1%82%D0%B5.pdf>
- Indeksi i hapjes së komunave për vitin 2021 - https://metamorphosis.org.mk/aktivnosti_arhiva/indeks-na-otvorenost-na-lokalnata-samouprava-2021-godina/
- Indeksi i transparencës aktive për vitin 2021 - https://www.ccc.org.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=441%3A-2021-&lang=mk
- Versione të mëparshme të PNA-së - <https://ovp.gov.mk/%d0%bd%d0%b0%d1%86%d0%b8%d0%be%d0%bd%d0%b0%bb%d0%b5%d0%bd-%d0%b0%d0%ba%d1%86%d0%b8%d1%81%d0%ba%d0%b8-%d0%bf%d0%bb%d0%b0%bd-%d0%b7%d0%b0-%d0%be%d0%b2%d0%bf/> ИТН.

Përveç analizës së dokumentacionit, janë bërë edhe 9 intervista me anëtarët dhe koordinatorët e grupeve të punës, si nga institucionet ashtu edhe nga organizatat qytetare të përfshira aktivisht në bashkëkrijimin e PNA 5 gjatë muajit tetor 2022..

ANEKSI I.

PASQYRA E IMPLEMENTIMIT TË TRANSPARENCËS, LLOGARIDHËNIES, PROAKTIVITETI DHE INKLUZIVITETIT

Legjenda



E GJELBËR = i realizuar (i përfunduar)








E VERDHË = në vijim (vetëm nëse ndërmerren të gjithë hapat e nevojshëm dhe angazhimi do të realizohet)



E KUQE = angazhim i pafilluar ose i filluar, por nuk ka përparim në implementim

Numri (njëjtë si në PA)	Emri i angazhimit	Emri i aksioneve	Statusi i realizimit
1.1.	Shpallja publike e pronarëve të vërtetë të firmave që kanë lidhur marrëveshje për prokurime publike	<p>1.1.1. Arritja e marrëveshjes për kriterin (pragu i vlerës) për cilat kontrata do të publikohen pronarët realë, si dhe një zgjidhje teknike e harmonizuar për shkarkimin automatik të të dhënave nga SEPP-ja</p> <p>1.1.2. Shpallja e emrave të pronarëve të vërtetë të subjekteve mbartës të prokurimeve publike</p>	
1.2.	Shpallje proaktive e informacioneve me karakter publik në ueb-faqe e institucioneve	<p>1.2.1. Vendosja e obligimit për çdo institucion - posedues i informacioneve, me patjetër të informojë në raportin e vet vjetor që ia dorëzon AQLI dhe për zbatimin e nenit 10 të Ligjit për qasje të lirë, i cili parashikon obligimin që poseduesit t'i shpallin të gjitha informacionet e veprimtarisë së vet në ueb-faqe</p> <p>1.2.2. Vendosja e obligimit për AQ LI-në për shpalljen e informacionit përmbledhës në raportin e vet vjetor dhe për zbatimin e nenit 10 të Ligjit për qasje të lirë, kurse në bazë të raporteve të marra nga poseduesit e informacioneve</p>	

Numri (njëjtë si në PA)	Emri i angazhimit	Emri i aksioneve	Statusi i realizimit
1.3.	Shpallja e informacioneve themelore për prokurimet publike në ueb-faqet e institucioneve	<p>1.3.1. Krijimi i pjesës së veçantë, (tab) për “Prokurime publike” në ueb-faqet e institucioneve (organet kontraktuese)</p> <p>1.3.2. Shpallen në ueb-faqen e çdo institucioni (në pjesën e “prokurimeve publike) këto informacione dhe dokumente:</p> <ul style="list-style-type: none"> → plani vjetor i prokurimeve publike (me të gjitha ndryshimet dhe plotësimet); → shpalljet për prokurimet publike (link i shpalljeve në SEPP); → lajmërimet për marrëveshjet e lidhura (link i shpalljeve në SEPP); → marrëveshjet e lidhura për prokurimet publike dhe → lajmërimet për marrëveshjet e realizuara (link i shpalljeve në SEPP) 	
1.4.	Përparimi i qasjes tek informacionet dhe i numrit të të dhënave të hapura të shpallura në njësitë e vetëqeverisjes lokale (NJVL)	<p>1.4.1. Njësitë e vetëqeverisjes lokale marrin pjesë në zbatimin e matjes së hapjes së njësive të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut nëpërmjet indeksit të hapjes</p> <p>1.4.2. Përparimi i njohurive për transparencën dhe të dhënat e hapura nëpërmjet mbajtjes së trajnimeve për përfaqësuesit e komunave</p> <p>1.4.3. Sigurimi i mbështetjes së drejtpërdrejtë në 30 NJVL (nëpërmjet fasilizuesve) për përparim të transparencës dhe hapjes së tyre</p>	
1.5.	Mundësimi i qasjes pa pagesë të të dhënave për organizatat qytetare	<p>1.5.1. Shpallja e të dhënave për organizatat qytetare në format të hapur në portalin e Regjistrimit qendror, portalit qeveritar për të dhëna të hapura</p> <p>1.5.2. Përditësim i rregullt i të dhënave nga pika e mësipërme</p> <p>1.5.3. Krijim i grupit të punës për përcaktim të kriterëve hyrësë dhe të dhënave dalëse për organizatat qytetare që do t’i përmbajnë raportet dinamike</p>	

Numri (njëjtë si në PA)	Emri i angazhimit	Emri i aksioneve	Statusi i realizimit
1.5.		<p>1.5.4. Mundësimi i qasjes të raportet dinamike me të dhëna të përshtatura për organizatat qytetare dhe përdoruesit e buxhetit (pushteti qendror dhe lokal)</p> <p>1.5.5. Trajnim dhe instruksione me shkrim për përdoruesit e buxhetit (pushteti qendror dhe lokal) për përdorim të raporteve dinamike</p> <p>1.5.6. Përdorimi i raporteve dinamike për organizatat qytetare</p>	
1.6.	<p>Transparenca fiskale dhe llogaridhënia në nivel lokal dhe përmirësimi i përfshirjes së qytetarëve nëpërmjet mekanizmave dhe mjeteve inovative</p>	<p>1.6.1. Vendosja dhe vënia në funksion e tabelave elektronike në 20 komuna ku do të shpallen automatikisht raportet tremujore mbi realizimin e buxhetit të komunës, të përpiluar në mënyrë të kuptueshme për qytetarët</p> <p>1.6.2. Krijimi dhe vendosja e mjeteve inovative për qasje më të lehtë tek informacionet dhe inkurajimi i përfshirjes së qytetarëve në 20 komuna</p> <p>1.6.3. Vendosja e mekanizmave për pjesëmarrje të qytetarëve në marrjen e vendimeve dhe përcaktimi i prioritetëve lokale, nëpërmjet përfaqësimit përkatës me theks në grupet vulnerable dhe të marginalizuara në 20 komuna</p>	

ANEKSI II.


BURIME/MATERIALE PËR VERIFIKIM

1. Raporti i indeksit të transparencës aktive 2021 2021, Qendra për komunikime qytetare, <https://www.ccc.org.mk/images/stories/akt22.pdf>
2. Raporti i Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut për vitin 2022, <https://www.sep.gov.mk/page/?id=1117#.Y4b6TXbMJPZ>
3. Plani nacional aksional për partneritet për qeverisje të hapur 2021-2023, NAP5-PARTNERSTVO-ZA-OTVORENA-VLAST-2021-2023-_-potvrden-od-Vlada-26.10.2021.pdf (ovp.gov.mk)
4. Raportet vjetore të punës së Agjencisë për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, <https://aspi.mk/%d0%b4%d0%be%d0%ba%d1%83%d0%bc%d0%b5%d0%bd%d1%82%d0%b8/%d0%b3%d0%be%d0%b4%d0%b8%d1%88%d0%bd%d0%b8-%d0%b8%d0%b7%d0%b2%d0%b5%d1%88%d1%82%d0%b0%d0%b8/>
5. Enti shtetëror i revizionit, kumtesë për mediat 06.12.2021, <https://dzt.mk/mk/210706-50-od-opshtinite-na-veb-portalite-nemaat-soodvetni-informacii>
6. Raporti i punës së Agjencisë për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik për vitin 2021, https://aspi.mk/wp-content/uploads/2022/04/%D0%93%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D1%88%D0%B5%D0%BD-%D0%B8%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98_MK.pdf
7. Procesverbali dhe përfundimet e mbledhjes së 40-të të Qeverisë së RMV-së, <https://vlada.mk/2022-40>
8. Të dhëna të hapura - Regjistri qendror i RMV-së, lista e organizatave qytetare, <https://www.crm.com.mk/mk/otvoreni-podatotsi/gragjanski-organizatsii>
9. Analiza e zbatimit të Ligjit për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik me rekomandime për përparim të sistemit për qasje të lirë tek informacionet – <https://aspi.mk/wp-content/uploads/2022/10/%D0%90%D0%BD%D0%B0%D0%BB%D0%B8%D0%B7%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D0%BF%D1%80%D0%B8%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D0%97%D0%A1%D0%9F%D0%98%D0%88%D0%9A-%D1%81%D0%BE-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D0%BF%D0%BE%D1%80%D0%B0%D0%BA%D0%B8-%D0%B7%D0%B0-%D1%83%D0%BD%D0%B0%D0%BF%D1%80%D0%B5%D0%B4%D1%83%D0%B2%D0%B0%D1%9A%D0%B5-%D0%BD%D0%B0-%D1%81%D0%B8%D1%81%D1%82%D0%B5%D0%BC%D0%BE%D1%82-%D0%B7%D0%B0-%D1%81%D0%BB%D0%BE%D0%B1%D0%BE%D0%B4%D0%B5%D0%BD-%D0%BF%D1%80%D0%B8%D1%81%D1%82%D0%B0%D0%BF-%D0%B4%D0%BE-%D0%B8%D0%BD%D1%84%D0%BE%D1%80%D0%BC%D0%B0%D1%86%D0%B8%D0%B8%D1%82%D0%B5.pdf>

10. Indeksi i transparencës aktive për vitin 2021 – https://www.ccc.org.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=441%3A-2021-&lang=mk
11. Versione të mëparshme të PNA-së – <https://ovp.gov.mk/%d0%bd%d0%b0%d1%86%d0%b8%d0%be%d0%bd%d0%b0%d0%bb%d0%b5%d0%bd-%d0%b0%d0%ba%d1%86%d0%b8%d1%81%d0%ba%d0%b8-%d0%bf%d0%bb%d0%b0%d0%bd-%d0%b7%d0%b0-%d0%be%d0%b2%d0%bf/>
12. Open Government Awards, 2021, <https://www.opengovpartnership.org/open-government-awards/>
13. <https://www.undp.org/>
14. Ministria e Vetëqeverisjes Lokale në RMV, <https://www.mls.gov.mk/>
15. Sistemi elektronik për furnizimet publike, <https://e-nabavki.gov.mk/PublicAccess/Home.aspx#/home>
16. Byroja për prokurimet publike, <https://www.bjn.gov.mk/>
17. Open Government Partnership, <https://www.opengovpartnership.org/>

MATERIALE TË DOBISHME

1. Microsoft Word - for web_2019-21-Design-Report-Template.docx (opengovpartnership.org)
2. Microsoft Word - for web_Implementation-Report-2017-19-APs-template_to-use-updated-12-17-19.docx (opengovpartnership.org)
3. IRM Reports and Analysis (opengovpartnership.org)
4. IRM Guidelines for the Assessment of Minimum Requirements (opengovpartnership.org)
5. NAP5-PARTNERSTVO-ZA-OTVORENA-VLAST-2021-2023- _potvrden-od-Vlada-26.10.2021.pdf (ovp.gov.mk)



Procesi është mbështetur nga Sekretariati i PQH- së për nevojat e projektit “Mbështetje e procesit të zbatimit dhe ndjekjes së Planit nacional aksional për Partneritet për qeverisje të hapur 2021 - 2023”, të cilin e zbaton Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedonia në partneritet me Qendrën për komunikime qytetare dhe Shoqatën për emancipim, solidaritet dhe barazi të grave, në bashkëpunim me Ministrinë për Shoqëri Informatike dhe Administratë.